



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 641 / Prot.

Tiranë, më 13 . 6 2016

V E N D I M

“Mbi lejimin e transferimit ndërkombëtar”

Nr. 37 , datë 13/6 2016

Në mbështetje të nenit 9 dhe pikës 1 të nenit 26 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës administruar me nr. 641 prot, datë 03.06.2016, për pajisje me autorizim për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale nga transferuesi **BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A** në marrësin **SOCIÉTÉ GÉNÉRALE GLOBAL SOLUTION CENTRE Pvt. Ltd;**

K O N S T A T O V A :

Subjekti kontrollues, Banka Societe Generale Albania Sh.a ka kërkuar nga Autoriteti i Komisionerit pajisjen me autorizim për transferimin e të dhënave personale në marrësin Société Générale Global Solution Centre Pvt. Ltd të vendosur në Voyager Building, 10th Floor, Ascendas ITPB SEZ, International Tech Park, Whitefield Road, Bangalore, 560 066, Karnataka, India.

Sipas deklarimeve të subjektit kontrollues, në *Formularin e Aplikimit për Aprovimin e Transferimit të të Dhënave Personale në një Shtet që nuk ka Nivel të Mjaftueshëm të Mbrojtjes së të Dhënave*, administruar pranë KDIMDP, transferimi që kërkohet të autorizohet nga Autoriteti i Komisionerit përmban elementët e mëposhtëm:

Kategoria e të dhënave objekt transferimi:

1. Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja);
2. Numri personal i identifikimit;
3. Adresa.

Shteti ku do të realizohet transferimi: Indi.

Kategoria e subjekteve të cilëve u transferohen të dhënat personale janë: Klientë.

Frekuenca e Transferimit është: Vazhdimisht, përditë.

Qëllimi i transferimit, citojmë: “Banka Societe Generale Albania Sh.a ofron shërbime të ndryshme për klientët e saj. Ndër të tjera ofron dhe kryerjen apo përcjelljen e urdhër pagesave të klientëve duke përdorur shërbimin SWIFT. Aktualisht ky shërbim ofrohet nga kompania mëmë

Societe Generale, Paris e cila ofron mbikëqyrjen e këtij shërbimi për të siguruar cilësinë e tij si dhe filtrimin dhe kontrollin e mesazheve SWIFT për të siguruar përputhshmërinë e tyre me rregulloret dhe kërkesat në fuqi në lidhje me embargot dhe sanksionet.

Në kuadër të përmirësimit të këtij shërbimi si dhe atij të filtrimit të mesazheve SWIFT për ngritjen e alarmeve në rast dyshimi për shkelje të rregulloreve të embargove dhe sanksioneve. Societe Generale Paris ka nënshkruar një marrëveshje nën kontraktimi me Societe Generale, Global Solution Centre (SG GSC) në Indi, që kjo e fundit të mbulojë gjatë orëve të natës apo jashtë orarit të punës në Francë shërbimet si më poshtë:

- 1. Mbikëqyrja e platformës që ofron shërbimin e SWIFT*
- 2. Trajtimi/procesimi i alarmeve në rast se ndonjë transaksioni që bllokohet nga filtrat që bëjnë kontrollin për embargo dhe sanksione*

Shërbimi i mbikëqyrjes së platformës SWIFT konsiston në sigurimin se kjo platformë është duke funksionuar si duhet, zgjidhjen e incidenteve të mundshme, duke u përgjigjur nevojave të filialeve të grupit dhe duke kontribuar në zhvillimet/përmirësimet e platformës. Ky shërbim nuk konsiston në përpunimin e transaksioneve financiare pra SG GSC në Indi nuk ka akses në përmbajtjen e këtyre transaksioneve, ajo është vetëm nënkontraktuar për të vëzhguar platformën gjatë orëve të natës apo jashtë orarit të punës në Francë. Personeli në Indi do të punojë nën mbikëqyrjen e një drejtuesi në SG, Paris.

Shërbimi i përpunimit të alarmeve të filtrimit, konsiston në analizimin e alarmeve (të krijuara nga transaksionet financiare kur filtrohen mbi bazat e të dhënave mbi sanksionet dhe embargot) dhe në dërgimin alarmeve relevante për vendimarrje. Për këtë proces, ne do të vazhdojmë të dërgojmë të dhënat për të filtruar në SG, Paris Francë. Filtrimi do të vazhdojë të kryhet në Francë dhe nëse gjenerohen alarme nga ky filtrim ata do të përpunohen nga ekipi në Francë apo në SG GSC në Indi.

Ekipi SG GSC në Indi, do të aksesojë në distancë/“on remote” në aplikacionet e nevojshme për t’u përdorur për përpunimin e alarmeve , duke respektuar të gjithë rregullat e sigurisë dhe sipas marrëveshjes së nënshkruar me SG, Paris. Ata do të jenë në gjendje për të parë përmbajtjen vetëm të transaksionit i cili ka gjeneruar alarm (fusha të ndryshme të transaksionit). Nëse alarmi konsiderohet relevant, ata do të dërgojnë për të marrë autorizimin për procesim ose jo të transaksionit”.

Ndërkohë në Rubrikën 7, të Formularit të Aplikimit “Rrethanat lidhur me përpunimin” subjekti transferues ka deklaruar, citojmë: “Për çdo klient në bankë, kemi implementuar Deklaratën e Pëlqimit për t’u firmosur prej tyre.

Gjithashtu, theksojmë se filtrimi i mesazheve SWIFT kryhet për mbrojtjen si të bankës por edhe të ndonjë klienti që mund të kryejë transaksione “i mashtruar” nga ndonjë palë tjetër”.

Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave, citojmë: “Të dhënat e mesazheve SWIFT ruhen vetëm nga SG, Paris në Francë, sipas ligjeve të këtij shteti. SG GSC në Indi akseson të dhënat vetëm në distancë/ “on remote”.

Në bazë të Vendimit të Komisionerit Nr. 3, datë 20.11.2013 "Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale", India nuk është në listën e vendeve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.

Në këto kushte në zbatim të nenit 9 pika 1, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, subjekti kontrollues Banka Societe Generale Albania Sh.a është në kushtet ku ky transferim duhet kryer pas marrjes së Autorizimit nga Komisioneri mbi ligjshmërinë e realizimit të tij.

Për këtë qëllim subjekti përveç Formularit të Aplikimit ka depozituar një sërë dokumentesh në mbështetje të kërkesës së tij për të legjitimuar transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale në marrësin e sipërcituar dhe konkretisht:

Kontratën për transferimin e të dhënave, Anex Klauzola Standarte Kontraktuale, Deklaratën e Pëlqimit të klientit (CSA-7-SG Paris Addendum for Forces Filtering, SWIFT platform Monitorin, GTPS Standard Contractual Clauses, SG GSC presentation, SG GSC-GTPS CSA-7).

Në mbështetje të dokumentacionit të paraqitur nga kontrolluesi dhe studimi i përmbajtjes së tyre rezulton që ky transferim të dhënash personale të jetë në përputhje me respektimin e mbrojtjes së të dhënave personale sipas akteve ndërkombëtare Direktiva 95/46/EC dhe vendase, dispozitat e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 41, datë 13.06.2014 për "Lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale".

Sa më sipër, kërkesa për marrjen e autorizimit nga Komisioneri për transferimin e të dhënave personale nga kontrolluesi Banka Societe Generale Albania Sh.a, plotëson kërkesat ligjore për t'u pajisur me Autorizim për transferimin e të dhënave personale të kërkuara;

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, shkronja b, c nenit 9, pika 2 dhe nenit 26 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar;

V E N D O S A :

1. Lejimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale nga kontrolluesi **Banka Societe Generale Albania Sh.a** duke përcaktuar si më poshtë:

Kontrolluesi **Banka Societe Generale Albania Sh.a** lejohet të transferojë tek marrësi i të dhënave **Société Générale Global Solution Centre Pvt. Ltd, Indi** kategorinë e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave klientë, si më poshtë:

- Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja);
- Numri personal i identifikimit;
- Adresa.

2. Të dhënat e cituara më sipër do të transferohen vetëm për qëllimin e deklaruar nga transferuesi në Formularin e Aplikimit për Autorizim mbi Transferimin e të Dhënave

Besnik DERVISHI
KOMISIONERI